

STATUTI
I SHOQERISE KONCESIONARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"G2 BLU" SH.P.K.

Sot me **06 Prill 2023** (dymije e njezete e tre), ne te nënshkruarit,

- (1) Shoqeria "**Gener 2**" Sh.p.k., person juridik shqiptar, i regjistruar me Vendimin Nr.30145, date 03.09.2003 te Gjykates se Rrethit Tirane, me NUIS K58615301M, adrese Rr. Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, Kati 7, Tirane, Shqiperi, përfaqësuar nga Administratorja e saj Zj. Artila Ulaj, identifikuar me Leternjoftimin Nr. 030021997, me Nr. Personal I15205096A, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (ne vijim "**Ortaku i Pare**"); dhe
- (2) "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" Sh.p.k., person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit me NIPT K61814023M, me adresë Rr. Sami Frasheri, Pallati Bjorn, Kati 11, Apt 38, Kodi Postar 1019, përfaqësuar nga Administratori Z. Olset Haxhiu, identifikuar me Leternjoftim Nr. 025295495, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (ne vijim "**Ortaku i Dyte**"); dhe
- (3) "I.D.K - KONSTRUKSION" Sh.p.k., person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit me NIPT K51408016J, me adresë Vorë, Autostrada Tiranë-Durrës, Km.12, Rr. Zaja, Kodër Bexulle, Nr.Pasurie 1014/3, ZK.1167, përfaqësuar nga Administratori Z. Gramos Dalipi, identifikuar me Leternjoftim Nr. H20512238U, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (ne vijim "**Ortaku i Trete**");
themelojmë një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar sipas legjislacionit Shqiptar ne fuqi, dhe ne përputhje me kushtet e përcaktuara ne këtë Statut:

Permbajtja e Statutit

NENI 1-EMËRTIMI	2
NENI 2-SELIA	2
NENI 3-OBJEKTI I SHOQËRISË	2
NENI 4-KOHËZGJATJA	2
NENI 5 -KAPITALI	3
NENI 6 -ORTAKET	3
NENI 7-KONTRIBUTET DHE FINANCIMET	4
NENI 8 -TRANSFERIMI I KUOTAVE	4
NENI 9 -ASAMBLEJA E ORTAKEVE DHE KOMPETENCAT E SAJ	5
NENI 10-PERFAQESIMI DHE KUORUMI	6
NENI 11-THIRRJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME	6
NENI 12-ADMINISTRIMI I SHOQERISE	9
NENI 13-KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT	9
NENI 14-PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT	10
NENI 15-VITI FINANCIAR DHE PASQYRAT FINANCIARE	10
NENI 16 -FITIMI DHE DIVIDENTET	10
NENI 17 -KONTROLLI	10



NENI 18-PRISHJA DHE LIKUIDIMI..... 11

NENI 19-LIGJI I ZBATUESHEM DHE JURIDIKSIONI..... 11

KREU I

EMERTIMI – SELIA – OBJEKTI - KOHEZGJATJA

Neni 1-Emërtimi

- 1.1 Shoqëria është krijuar ne formën e një shoqërie me përgjegjësi te kufizuar. Emërtimi i shoqërisë është **"G2 BLU"** sh.p.k (ne vijim e quajtur "Shoqëria"). Shoqëria do te fitoje personalitet juridik pas regjistrimit te saj me Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombëtare te Biznesit.
- 1.2 Shoqëria ushtron aktivitetin e saj ne përputhje me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" ("Ligji Tregtar"), te ndryshuar, legjislacionin shqiptar ne fuqi, dhe me këtë Statut. Ne rast se dispozitat e ketij statuti bien ne kundërshtim me ligjin, ky i fundit do te kete perparesi.

Neni 2-Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën: **Njesia Bashkiake Nr. 1, Rruga "Papa Gjon Pali i II-te", Ndertesa Nr. 12, Aba Business Center, Kati i 7-te, Tiranë, Shqiperi.**

Te dhenat kadastrale te pasurise se paluajtshme ku ndodhet Selia jane: Nr. Pasurie 7/52-N9 ne ne katin e 7-te teknik ne Qendren e biznesit "ABA Business Center", e llojit "Njesi", regjistruar ne Zyren e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme, Tirane, Zona Kadastrale 8160, vol. 36, faq. 212;

- 2.2 Shoqëria mund te krijojë dege, zyra, filiale dhe te zhvillojë aktivitet ne vende te tjera, brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë me vendim te ortakeve te Shoqërisë.

Neni 3-Objekti i Shoqërisë

- 3.1 Shoqëria ka për objekt dhe qëllim te saj aktivitetet tregtare në përputhje me legjislacionin në fuqi ne funksion te Koncesionit/ Partneritetit Publik Privat: "Per Projektimin, Ndërtimin, Operimin, Mirëmbajtjen, Rrehabilitimin dhe Transferimin e Segmentit Rrugor Milot – Thumanë", per te cilen Ortaket e Shoqerise jane njoftuar si Operatori Fitues, dhe ne zbatim te parashikimeve te Kontrates se Koncesionit qe do te nenshkruaje Shoqeria, me Ministrine e Infrastruktures dhe Energjise ne cilesine e Autoritetit Kontraktues, per kete Koncesion/ Partneritet Publik Privat "Per Projektimin, Ndërtimin, Operimin, Mirëmbajtjen, Rrehabilitimin dhe Transferimin e Segmentit Rrugor Milot – Thumanë", (ketu e me poshte referuar si "Kontrata e Koncesionit").
- 3.2 Shoqëria mund te kryejë çdo veprimtari te nevojshme e te dobishme, te lejuar nga ligji për realizimin e objektit te aktivitetit te saj.

Neni 4-Kohëzgjatja

- 4.1 Shoqëria do te zhvillojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje te pacaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar te Republikës se Shqipërisë.
- 4.2 Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do te përcaktohet me vendim te asamblesë se ortakeve ne përputhje me dispozitat e ketij Statuti dhe legjislacionin ne fuqi.

KREU II



KAPITALI

Neni 5 -Kapitali

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është **100.000,00** Leke (Njeqindmije Leke), dhe ndahet ne **3 kuota**, te cilat zoterohet nga ortakët e saj. Kapitali themeltar është i nënshkruar nga ortakët Shoqërisë te percaktuar ne Nenin 6.
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë apo çdo kontribut ne para për zmadhimin e kapitalit paguhet ne llogarinë bankare te Shoqërisë.
- 5.3 Kuotat janë te transferueshme sipas kushteve te përcaktuara ne Ligjin Tregtar, dhe ne këtë Statut.
- 5.4 Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri ne vlerën e kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6 -Ortakët

- 6.1 Ortakët e Shoqërisë janë si vijon:
 - a) Shoqëria "Gener 2" Sh.p.k., person juridik shqiptar, i regjistruar me Vendimin Nr.30145, date 03.09.2003 te Gjykes se Rrethit Tirane, me NUIS K58615301M, adrese Rr. Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, Kati 7, Tirane, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratorja e saj Zj. Artilla Ulaj, identifikuar me Letërnjoftimin Nr. 030021997, me Nr. Personal I15205096A, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, **(ne vijim "Ortaku i Pare")**;

Ortaku i Pare zoteron 1 (nje) kuote me vlere nominale 98.000,00 (nentedhjetete e tete mije) Leke, qe perfaqeson 98% (nentedhjetete e tete perqind) te kapitalit te regjistruar te shoqërisë dhe te te drejtave te votes ne asamblene e pergjithshme te ortakëve sipas ketij statuti.
 - b) "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" Sh.p.k., person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit me NIPT K61814023M, me adresë Rr. Sami Frashëri, Pallati Bjorn, Kati 11, Apt 38, Kodi Postar 1019, përfaqësuar nga Administratori Z. Olset Haxhiu, identifikuar me Letërnjoftim Nr. 025295495, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar **(ne vijim "Ortaku i Dyte")**; dhe

Ortaku i Dyte zoteron 1 (nje) kuote me vlere nominale 1.000,00 (nje mije) Leke, qe perfaqeson 1% (nje perqind) te kapitalit te regjistruar te shoqërisë dhe te te drejtave te votes ne asamblene e pergjithshme te ortakëve sipas ketij statuti.
 - c) "I.D.K - KONSTRUKSION" Sh.p.k., person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit me NIPT K51408016J, me adresë Vorë, Autostrada Tiranë-Durrës, Km.12, Rr. Zaja, Kodër Berxulle, Nr.Pasurie 1014/3, ZK.1167, përfaqësuar nga Administratori Z. Gramos Dalipi, identifikuar me Letërnjoftim Nr. H20512238U, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar **(ne vijim "Ortaku i Trete ")**;

Ortaku i Trete zoteron 1 (nje) kuote me vlere nominale 1.000,00 Leke (nje mije), qe perfaqeson 1% (nje perqind) te kapitalit te regjistruar te shoqërisë dhe te te drejtave te votes ne asamblene e pergjithshme te ortakëve sipas ketij statuti.

Në vijim të tre ortakët bashkarisht do të referohen si "Ortakët".

6.2. Ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti, nje person mund te pranohet kohe pas kohe si ortak ne Shoqëri vetem nese ky ortak i ri do t'i permbahet kushteve dhe termave te kontrates se Koncesionit/partneritetit publik privat "Per Projektimin, Ndërtimin, Operimin, Mirëmbajtjen, Rrehabilitimin dhe Transferimin e Segmentit Rrugor Milot - Thumanë", qe



do te nenshkrhet me Ministrine e Infrastruktures dhe Energjise ne cilesine e Autoritetit Kontraktues, dhe ky ndryshim eshte ne perputhje me dhe ploteson kerkesat e percaktuara nga Kontrata e Koncesionit.

- 6.3 Adresa e ortakeve për efekt të marrëdhënies së tyre me Shoqërinë, është ajo që rezulton nga regjistri i ortakeve. Është detyrim i ortakeve të njoftojnë ndryshimin e adresës së tyre. Administratori ka për detyrë të mbaje dhe përditësojë këtë regjistër.

Neni 7-Kontributet dhe Financimet

- 7.1 Kontributi i ortakeve në kapitalin e Shoqërisë mund të jetë në para ose në natyrë, si pasuri të luajtshme, të paluajtshme apo të drejta.
- 7.2 Shoqëria, me kërkesë të Administratorit dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, mund të grumbullojë financime nga ortakët, me të drejtë kthimi, jo detyrimisht në përpjesëtim me kuotat e pjesëmarrjes të secilit në kapitalin e Shoqërisë. Përveç kur parashikohet në mënyrë specifike nga asamblëja e përgjithshme e ortakeve, financimet e ortakeve në favor të Shoqërisë do të konsiderohen pa qëllim fitimi.

Neni 8 -Transferimi i Kuotave

- 8.1 Procedurat dhe veprimet e transferimit të kuotave dhe/ose transferimi i pjesëve në rruge trashëgimie, si dhe transferimi tek persona të tjerë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, iu nënshtrohen dispozitave të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", pjesa që bën fjalë për transferimin e kapitalit themelues në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar si dhe nënveçkatëse në Kontratat e Koncesionit për transferimin e kuotave në shoqëri koncesionare.
- 8.2 Për transferimin e kuotave tek Persona të Tjerë që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri zbatohet procedura e mëposhtme:
- 8.2.1 Shitësi detyrohet të njoftojë me shkrim ortakët e tjerë (Pranuesin e Ofertës), për dëshirën apo qëllimin për t'i shitur të gjitha apo disa kuota të tij, një pale të tjerë. Ky njoftim duhet t'i kryhet me shkrim të Pranuesit/it/ve të Ofertës. Ky Njoftim ("Njoftimi i Shitjes") duhet të përmbajë:
- (i) numrin e kuotave në pronësi efektive të Shitësit;
 - (ii) numrin e kuotave që përbejnë Kuotat e Ofruara për shitje, çmimin dhe afatet e kushtet të shitjes së Kuotat të Ofruara për shitje;
 - (iii) emrin e blerësit të propozuar;
 - (iii) bashkëngjitur kopjen e nënshkruar të Letrës së Mirëkuptimit apo marrëveshjes ndërmjet Shitësit dhe Blerësit të propozuar.
- 8.2.2 Çdo Pranues i Ofertës brenda periudhës prej tridhjetë (30) ditëve nga dita kur Njoftimi i Shitjes do të mendohet se i është dhënë, mundet të njoftojë me shkrim Shitësin. Ky njoftim ("Njoftimi i Blerjes") duhet të theksojë qartë se Pranuesi i Ofertës dëshiron apo nuk dëshiron t'i blejë Kuotat e Ofruara për shitje. Nëse Pranuesi i Ofertës dëshiron në dhënie të Njoftimit të Blerjes, ai do të konsiderohet se ka refuzuar t'i blejë Kuotat e Ofruara.
- 8.2.3 Pasi Shitësi të këtë marrë të gjitha Njoftimet për Blerje të mundshme, apo pas kalimit të afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga data e Njoftimit të Shitjes, cili do të është me i hershem, Shitësi detyrohet t'ia shesë të gjitha Kuotat e Ofruara për shitje, të Pranuesit/it/ve të Ofertës i cili/te çilet në Njoftimin për Blerje ka/në shfaqur dëshirën për blerjen e Kuotat të Ofruara për shitje (me poshtë do të quhen "Blerësit") sipas çmimit dhe kushteve të percaktuara në Njoftimin e Shitjes.
- 8.2.4 Nëse me shumë se një Pranues i Ofertës ka bërë një Njoftim për Blerje drejtuar Shitësit duke shfaqur dëshirën e tij/saj për të blerë Kuotat e Ofruara, atëherë, Blerësit do të



- blejnë të gjitha Kuotat duke përfshirë Kuotat e Ofruara për Shitje, në masën për të çilen është rënë dakord midis tyre, ose, në mungesë të marrëveshjes, Pro-rata me kuotat e zotëruara nga secili Blerës duke mos i llogaritur kuotat e Shitësit.
- 8.2.5 Nëse Pranuesi/t e Ofertës, për shkak të arsyeve të parashikuara në dispozitat e mësipërme, nuk i blejnë Kuotat e Ofruara për Shitje, atëherë Shitësi do të jetë i lire të ia shesë kuotat e ofruara për shitje, Blerësit të propozuar në Njoftimin e Shitjes, por vetëm sipas çmimit të cilit është i njëjti apo më i madh se çmimi i përcaktuar në Njoftimin e Shitjes dhe sipas kushteve të parashikuara në Njoftimin e Shitjes apo kushteve me të favorshme për Shitësin, se sa ato të parashikuara në Njoftimin e Shitjes. Nëse, brenda një qind e pesëdhjetë (150) ditëve nga data e kalimit të afatit prej tridhjetë (30) ditëve, gjatë të cilit të Ofertuari/t kanë mundur të i shfrytëzojnë të drejtat e tyre të përshkruara më lart, Shitësi nuk e ka përfunduar procesin e shitjes së Kuotave të Ofruara tek Blerësi i propozuar i treguar në Njoftimin e Shitjes, atëherë të drejtat e Pranuesit të Ofertës lidhur me Kuotat e Ofruara për shitje do të ripërtërihen dhe nëse Shitësi edhe me tutje dëshiron të shesë ndonjë nga kuotat e tij, duhet të kryejë përsëri një Njoftim në përputhje me paragrafin 8.2 të këtij Neni 8 dhe kështu me radhë here pas here.
- 8.2.6 Çdo oferte për shitjen e kuotave drejt një pale të treta duhet patjetër të përfshijë kushtin që pala e treta të bëjë dakord që të bëhet pale e këtij Statuti, si dhe e të gjitha marrëveshjeve të ortakeve, nëse ka të tilla, të cilat janë në fuqi para bërjes së kuotave.
- 8.3 Te Drejtat e Parablerjes. Dispozitat në vijim do të zbatohen për kontributet e reja në kapitalin e Shoqërisë:
- 8.3.1 Nëse shoqëria propozon rritjen e kapitalit duke kërkuar kontribute të reja ("Kontributet e Reja"), Kontributet e Reja do të u kerkohen të gjithë ortakeve. Shoqëria do të i dërgojë një Njoftim me shkrim ("Njoftimi për Kontribute") secilit ortak.
- 8.3.2 Çdo ortak i cili dëshiron të paguajë për një pjesë ose për gjithë Kontributet e Reja, duhet ta njoftojë me shkrim Shoqërinë.
- 8.3.3 Nëse ndonjëri nga ortaket pranon ofertën e përcaktuar në Njoftimin për Kontribute, ortaku duhet të nënshkruajë Kontributet e Reja në përputhje me Njoftimin për Kontribute dhe duhet menjëherë të nënshkruajë gjithashtu një pranim me shkrim i cili do të pranohet menjëherë nga shoqëria. Ortaket do të kenë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë Kontributet e Reja në masën mbi të cilën ata kanë rënë dakord, ose në mungesë të një marrëveshjeje të tillë, në mënyrë proporcionale me numrin e kuotave që zotëron secili ortak.
- 8.3.4 Çdo Kontribut i Ri i cili nuk është nënshkruar nga ortaket në përputhje me paragrafin 8.2 të këtij Neni 8, mund të i ofrohet një pale të treta të interesuar nga Shoqëria sipas çmimit dhe afateve të përcaktuara në Njoftimin për Kontributet.
- 8.4 Kufizimet e Transferimit
- 8.4.1 Ortaku i Dytë dhe/ose Ortaku i Treta nuk mund të shesin, transferojnë, disponojnë, dhurojnë, ta lenë hipoteke apo peng, ngarkojnë me ndonjë barre tjetër (se bashku "Disponim") kuotën e tij/tyre pa miratimin paraprak të Ortakut të Pare – Gener 2 sh.p.k. Çdo shitje, akordim transferim, disponim, dhurim, hipoteke, peng, apo ndonjë barre tjetër mbi kuotat e vendosur pa miratimin paraprak të Ortakut të Pare do të konsiderohet nul/e pavlefshme, dhe nuk do të krijojë efekte për Shoqërinë.
- 8.4.2 Asnjë Ortak nuk mund të disponojë kuotën e tij në kundërshtim me parashikimet e Kontrates së Koncesionit.

KREU III
ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Neni 9 -Asambleja e ortakeve dhe kompetencat e saj

9.1 Në bazë të ligjeve dhe dispozitave të këtij Statuti, asambleja e përgjithshme e ortakeve të Shoqërisë është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Ajo përfaqëson të gjithë ortaket



dhe vendimet e saj, te marra ne perputhje me ligjin dhe kete Statut, jane detyruese per te gjithë ortaket, perfshire ata qe nuk marrin pjese ne votim dhe qe votojne kunder ketyre vendimeve.

- 9.2 Vendimet per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise mund te miratohen ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme te ortakeve ose nepermjet konsultimit me shkrim:
- a) percaktimi i politikave tregtare te Shoqerise;
 - b) miratimi i ndryshimeve te Statutit;
 - c) emerimi e shkarkimi i Administratorit si dhe percaktimi i kompetencave dhe shperblimit te tij;
 - d) emerimi e shkarkimi i likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar si dhe percaktimi i shperblimit te tyre;
 - e) mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori, perfshire mbikeqyrjen e pergatitjes se pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - f) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates dhe brenda gjashte muajsh nga perfundimi i vitit financiar;
 - g) zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates;
 - h) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) caktimin e perfaqesuesit te Shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj Administratorit;
 - j) miratimin e riorganizimit te Shoqerise, perfshire bashkimin me shoqeri te tjera, ndarjen e Shoqerise, shnderrimin e Shoqerise si dhe prishjen e Shoqerise;
 - k) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese se ortakeve.

Neni 10-Perfaqesimi dhe Kuorumi

- 10.1 Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne asamblene e pergjithshme dhe te votoje sipas kuotave qe zoteron ne kapitalin e nenshkruar e te shlyer te Shoqerise.
- 10.2 Ortaket mund te perfaqesohen ne asamblene e pergjithshme nga nje ortak tjetër apo nje person i trete i autorizuar nepermjet prokures me shkrim.
- 10.3 Perveç se kur parashikohet ndryshe nga Statuti, asambleja e pergjithshme e ortakeve vendos ne menyre te vlefshme kur ne mbledhje marrin pjese ortaket me te drejte vote qe perfaqesojne jo me pak se 70% (shtatedhjete perqind) te numrit total te votave dhe vendimet merren me votat pro te me shume se 75% (shtatedhjete e pese) perqind te ortakeve te pranishem. Ky parashikim nuk do te zbatohet ne rastin e emerimit dhe shkarkimit te Administratorit, rast ne te cilin asambleja e pergjithshme vendos ne menyre te vlefshme kur ne mbledhje marrin pjese ortaket me te drejte vote qe perfaqesojne me shume se 30% (tridhjete perqind) te numrit total te votave dhe vendimet merren me votat pro te me shume se 50% (pesedhjete) perqind te ortakeve te pranishem (Shumica e zakonshme e percaktuar nga Ligji Tregtar).
- 10.4 Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te vendose per shkak te mungeses se kuorunit te percaktuar me lart, ajo mblidhet perseri jo me vone se 30 (tridhjete) dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11-Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- 11.1 Asambleja e pergjithshme e ortakeve duhet te thirret te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar per miratimin e pasqyrave financiare dhe



raportit te ecurise se veprimtarise te Shoqerise te hartuar nga Administratori, si dhe çdo here qe gjykohehet e nevojshme nga Administratori, si dhe kur kjo kerkohehet me shkrim nga nje ose disa ortake qe zoterojne te pakten 5% (pese perqind) te kapitalit te Shoqerise. Ne rastin e fundit nese Administratori nuk e therret asamblene brenda 15 (pesembedhjete) ditesh nga paraqitja e kerkeses se ortakeve te siperpermendur, keta te fundit kane te drejte ta therresin vete asamblene e pergjithshme te ortakeve, duke percaktuar rendin e dites, kohen dhe vendin e takimit ne perputhje me procedurat e percaktuara ne dispozitat ne vijim.

11.2 Gjithashtu asambleja e ortakeve thirret ne rastet kur:

- (a) sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 (tre) muajve ne vazhdim.
- (b) shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5% (pese perqind) te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- (c) shoqeria, brenda 2 (dy) viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% (pese perqind) te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

11.3 Asambleja e pergjithshme e ortakeve mblidhet ne seline ligjore apo prane nje vendi tjeter brenda ose jashte Shqiperise.

11.4 Mbledhja e asamblese se pergjithshme te ortakeve thirret me ane te nje njoftimi me shkrim te derguar me poste te regjistruar ose faks ose nepermjet postes elektronike qe i drejtohet secilit prej ortakeve. Njoftimi duhet te tregojte rendin e dites, vendin, daten dhe oren e mbledhjes dhe do t'i dergohet secilit ortak, jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Gjithashtu, njoftimi duhet te permbaje, edhe menyren e pjesemarrjes ne asamblene e ortakeve dhe/ose menyren e vendimmarrjes.

11.5 Njoftimi i mbledhjes mund te parashikojte edhe nje date te dyte per mbledhjen e asamblese ne rast se mbledhja e pare nuk zhvillohet sipas njoftimit, ne perputhje me percaktimin ne nenin 10.4 te ketij Statuti.

11.6 Ne rastin kur njoftimi i mbledhjes behet nepermjet postes elektronike (e-mail), njoftimi konsiderohet i marre nga ortaket ne daten/oren e shenuar ne mesazhin e marrjes/dorezimit te njoftimit te postes elektronike.

11.7 Ne rastin kur njoftimi i mbledhjes behet me faks, njoftimi konsiderohet i marre nga ortaket ne date/oren e shenuar ne mesazhin e marrjes/dorezimit te gjeneruar nga pajisja e faksit.

11.8 Mbledhjet e asamblese se pergjithshme te ortakeve dhe vendimet e saj jane te vlefshme, edhe pa thirrje formale, kur marrin pjese te gjithe ortaket qe perfaqesojne te gjithe kapitalin e Shoqerise.

11.9 Asambleja e pergjithshme e ortakeve kryesohet nga personi i emeruar nga shumica e ortakeve pjesemarrres (ne vijim i quajtur "Kryetari i Mbledhjes").

11.10 Kryetari i Mbledhjes emerohet sekretarin, i cili harton procesverbalin e mbledhjes se asamblese.

11.11 Ortaket mund te marrin pjese ne mbledhjen e asamblese nepermjet mjeteve elektronike si telekonferenca, video-konferenca, apo komunimit video-shkrues.

11.12 Perdorimi i mjeteve elektronike do te kryhet duke marre te gjitha masat teknike te nevojshme per garantimin e identifikimit te ortakeve, si edhe sigurime e ketyre mjeteve elektronike. Ne vecanti eshte e nevojshme qe:



- (i) Kryetari i Mbledhjes te kete mundesine te verifikojte dhe te identifikojte ortaket te cilet jane te pranishem, te kontrolloje mbarevajtjen e mbledhjes, te numeroje dhe te shpalle rezultatin e votimit;
 - (ii) Sekretari dhe/ose mbajtessi i procesverbalit te kete mundesine per t'u njohur me faktet dhe ngjarjet e ndodhura ne mbledhjen, objekt te procesverbalit;
 - (iii) Te mundesohet pjesemarrja e te gjitha te pranishmeve per te diskutuar mbi rendin e dites, ne shqyrtimin, marrjen dhe shperndarjen e te gjitha dokumentave te perdorura gjate mbledhjes si dhe ne procesin e votimit mbi rendin e dites.
- 11.13 Mbledhja e asamblese ne kushtet e permendura ne nenin 11.11 dhe vijues te ketij Statuti, konsiderohet rregullisht e mbajtur ne vendin ku eshte i pranishem Kryetari i Mbledhjes, Sekretari ose mbajtessi i procesverbalit, i cili ben te mundur pergatitjen dhe mbajtjen e procesverbalit te mbledhjes.
- 11.14 Kryetari i Mbledhjes do te verifikojte identitetin e çdo ortaku pjesemarrës ose perfaqesuesve te tyre.
- 11.15 Ne rast se ortaket jane te ftuar te marrin vendime nepermjet konsultimit me shkrim, kuorumi do te quhet si i formuar bazuar ne numrin e ortakeve qe do te dergojne votimin dhe vendimet e tyre me shkrim. Administratori ose ortaket e tjere qe kerkojne vendimarrjen duhet t'i dergojne çdo ortaku njoftimin per konsultimin me shkrim, i cili do te permbaje gjithe informacionet qe perfshihen ne letren e njoftimit/thirrjes te percaktuar ne nenin 11.4 te ketij Statuti. Procedura e konsultimit me shkrim duhet te kryhet ne perputhje me permbajtjen e ketij neni, ne rastet kur zbatohet. Çdo ortak duhet te shprehet me shkrim ne lidhje me projekt-vendimet duke votuar mbi dokumentin e projekt vendimeve ne formen e derguar nga Administratori, nepermjet shenimit "pro" ose "kunder" ose duke u shprehur komentet e tyre ne nje dokument tjetër. Ne rast se ortaket kane komente, duhet t'u bejne reference te qarte projekt-vendimeve. Secili ortak duhet t'i dergoje Administratorit ose ortakeve qe kane kerkuar marrjen e vendimit nepermjet keshillimit me shkrim, voten e tij/vendimet me shkrim brenda dates se percaktuar ne njoftimin e derguar per marrjen e vendimin nepermjet konsultimit me shkrim.
- 11.16 Vendimet e ortakeve te marra si dhe diskutimet dhe komentet e ortakeve duhet te pasqyrohen ne procesverbalin e mbledhjes te hartuar nga Sekretari i mbledhjes. Gjithashtu ky procesverbal duhet te pasqyroje menyren e organizimit te mbledhjes se asamblese apo te konsultimit me shkrim nese eshte kryer ne perputhje me ligjin dhe dipozitat e Statutit, te identifikojte ortaket e pranishem dhe te perfaqesuar ose ortaket qe kane votuar me shkrim, nese kuorumi i ortakeve qe kane votuar me shkrim eshte respektuar sipas Statutit dhe Ligjit Tregtar, si dhe nese vendimet konsiderohet te miratuara sipas votave te marra. Procesverbali do te nenshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes. Procesverbalit i bashkengjitet gjithashtu lista e ortakeve qe kane votuar (pervec rastit kur procesverbali eshte nenshkruar nga gjithe ortaket) si dhe njoftimi i thirrjes se asamblese te cilat mbahen ne seline e Shoqerise. Nese vendimet e marra nga ortaket duhet te depozitohen prane Regjistrimit Tregtar, procesverbali i mbledhjes dhe votat e dhena (nepermjet konsultimit me shkrim nga ortaket) do te shërbejne si dokumentet qe provojne te dhenat qe do te depozitohen ne kete regjister.
- 11.17 Ne rast se asambleja e pergjithshme e ortakeve nuk mund te shqyrtoje ne te njejten dite te gjitha çështjet qe duhen diskutuar, vazhdimi i mbledhjes do te behet te nesermen pa pasur nevojte per njoftim te metejshem.
- 11.18 Te gjitha njoftimet, kerkesat, padite, apo komunikimet e tjera do te behen ne forme te shkruar dhe do t'u jepen apo nisen (dhe do te konsiderohen sikur jane derguar ne menyren e duhur ose kryer ne momentin e marrjes) tek Ortaket perkates ne adresat e Percaktuara ne regjistrin e ortakeve sipas percaktimeve te Nenit 6.3 te statutit.



KREU IV
ADMINISTRIMI I SHOQERISE



Neni 12-Administrimi i Shoqerise

- 12.1 Administrimi i Shoqerise do te kryhet vetem nga Administratori i propozuar nga Ortaku i Pare- "Gener 2" sh.p.k. dhe i emeruar me shumice te thjeshte/te zakonshme te votave ne asamblene e ortakeve sipas parashikimeve te Nenit 10.3 te Statutit.
- 12.2 Administratori do te emerohet nga asambleja e ortakeve dhe mund te shkarkohet ne çdo kohe me vendim te asamblese se ortakeve.
- 12.3 Administratori do te jete person fizik pa asnje kufizim per sa i perket kombesise se tij. Afati i emerimit i te Administratorit do te caktohet ne momentin e emerimit te tyre por ky afat nuk mund te jete me i gjate se 5 (pese) vjet. Pa cenuar kete kufizim afati i emerimit te tyre mund te ripërterihet me vendim te asamblese se ortakeve.
- 12.4 Administratori do te rimburohet per shpenzimet e kryera gjate ushtrimit te detyrave te tij. Asambleja e ortakeve mund te vendose te jape edhe shperblime vjetore.
- 12.5 Ne rast doreheqje Administratori do te njoftoje me shkrim asamblene e ortakeve. Doreheqja do te hyje ne fuqi ne momentin e emerimit te Administratorit te ri.
- 12.6 Administratori do te administroje veprimtarine e perditshme te Shoqerise ne perputhje me kete Statut dhe dhe legjislacionin e aplikueshem perkates.

Neni 13-Kompetencat e Administratorit

- 13.1 Administratori i pare i Shoqerise do te jete **Z. Gezim Pani, shtetas shqiptar i datelindjes 22.08.1978 dhe banues ne Tirane ne adresen: Rruga "Faik Konica" Tirane, i pajisur me karten e identitetit Nr. 025328598 dhe me Nr. Personal H80822036L**, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, **i cili** do te emerohet per nje mandat fillestar 3 (tre) vjecar me te drejte ri-emerimi.
- 13.2 Administratori do te jete pergjegjes per administrimin e Shoqerise dhe do te perfaqesoje Shoqerine kundrejt paleve te treta ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti dhe/ose te ligjit te zbatueshem. Administratori ka kompetenca te plota per te marre vendime te zakonshme dhe te jashtezakonshme per administrimin e Shoqerise, pervec kompetencave qe do te ushtrohen nga organe te tjera te Shoqerise sipas ketij Statuti ose ligjit te zbatueshem.
- 13.3 Administratori do te kete keto kompetenca dhe detyra qe lidhen me administrimin dhe mbikeqyrjen e veprimtarise se Shoqerise si me poshte:
 - (a) te mbikeqyre dhe te zbatoje politikat tregtare te Shoqerise dhe vendimet e asamblese se pergjithshme te ortakeve;
 - (b) te siguroje qe Shoqeria respekton ligjin(et) e zbatueshem dhe standardet kontabel;
 - (c) te kryeje te gjitha veprimet ne lidhje me administrimin e veprimtarise tregtare te Shoqerise;
 - (d) te perfaqesoje Shoqerine kundrejt paleve te treta;
 - (e) te siguroje qe dokumentet dhe librat kontabel te Shoqerise te mbahen rregullisht;
 - (f) te therrase mbledhjet e asamblese se pergjithshme te ortakeve, nese e vlereson te nevojshme per mbrojtjen e interesave te Shoqerise;
 - (g) te pergatite dhe nenshkruaje pasqyrat financiare vjetore te Shoqerise, dhe raportin e ecurise se veprimtarise te cilat bashke me propozimin per shperndarjen e fitimit i paraqiten per miratim asamblese se pergjithshme te ortakeve.
 - (h) te kryeje te gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme ne lidhje me Shoqerine sipas parashikimeve te ligjit te zbatueshem;



- (i) t'i raportoje asamblese se pergjithshme te ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe kryerjen e veprimtarive tregtare qe mund te konsiderohen me rendesi te vecante per Shoqerine;
 - (j) te punesoje ose te nderprese marredheniet e punes me punonjesit sipas politikave te Shoqerise;
 - (k) te kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne Statut.
- 13.4 Administratori mund te ushtroje te gjitha kompetencat si dhe te kryeje te gjitha veprimet te cilat me ligj ose nga ky Statut tjeter nuk i rezervohen kompetencave te asamblese se ortakeve ose nuk kufizohen nga ky Statut apo nga ligji i zbatueshem.
- 13.5 Administratori mund te delegoje pjeserisht ose teresisht kompetencat e tij tek persona te tjere te zgjedhur sipas gjykimit te tij.

Neni 14-Pergjegjesite e Administratorit

- 14.1 Administratori per nje veprim te caktuar ne te cilin perfshihen interesa te tij ose te paleve te treta te lidhura me te, te cilat i kundervihen interesave te Shoqerise duhet te njoftoje asamblene e ortakeve si dhe mund te mos marre pjese ne vendimet qe lidhen me keto veprime.
- 14.2 Administratori, kur personalisht apo permes paleve te lidhura me te ashtu siç percaktohen ne nenin 13 te ligjit 9901 me date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", kane interesa ne marreveshje te cilat do te lidhen nga Shoqeria duhet te njoftojne asamblene e ortakeve. Perfundimi i i nje marreveshje te tille duhet te miratohet nga asambleja e ortakeve.
- 14.3 Administratori duhet te ushtroje detyrat e tij ne menyre te kujdesshme ne perputhje me kete Statut, ligjin e aplikueshem ne fuqi dhe vendimet e asamblese se ortakeve.

KREU V

VITI FINANCIAR-KONTROLLI KONTABEL-PRISHJA DHE LIKUJDIMI

Neni 15-Viti financiar dhe pasqyrat financiare

- 15.1 Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor te çdo viti.
- 15.2 Ne perfundim te çdo viti financiar, Administratori harton pasqyrat financiare ne perputhje me ligjin.

Neni 16 -Fitimi dhe Dividentet

Fitimet qe rezultojne nga pasqyrat financiare te miratuarado te shperndahen midis ortakeve, pervec rasteve kur eshte vendosur ndryshe nga ortaket ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme ose nepermjet konsultimit me shkrim, ose do te perdoret per qellime te tjera sipas vendimit te asamblese se pergjithshme te ortakeve. Fitimi qe mund te shperndahet tek ortaket konsiston ne fitimin e vitit aktual, fitimin e realizuar ne vitet e kaluara dhe te mbartur, fitimi i realizuar ne vitet e kaluara i cili ishte destinuar per rezerven ligjore, kur qellimi i krijimit te rezerves eshte permbushur dhe ortaket vendosin te shfuqizojme rezerven ne fjale.

KREU VI

KONTROLLI KONTABEL

Neni 17 -Kontrolli

Nese kerkohet nga ligji, eksperti dhe/ose ekspertet emerohen nga asambleja. Asambleja e ortakeve mund te nmerroje te njejtin/et ekspert/e. Eksperti/et shkarkohet/n nga detyra me vendim te asamblese



se ortakeve ne rast mosrespektimi te detyres se tij, ne rast gabimi dhe ne rast mungese profesionalizmi ne sjellje.

**KREU VII
PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

Neni 18-Prishja dhe Likuidimi

- 18.1 Asambleja e ortakeve mund te vendose per prishjen e Shoqerise. Prishja e Shoqerise do te shoqerohet me likuidimin e saj.
- 18.1 Shoqeria vazhdon te ekzistojte si person juridik vetem per nevoja te likuidimit deri ne perfundim te ketij procesi dhe gjate likuidimit togfjaleshi "ne likuidim e siper" duhet te vihet pas emrit te Shoqerise.
- 18.1 Likuiduesi/t do te emerohet me vendim te Asamblese se ortakeve. Emerimi i likuiduesit/eve dhe procesi i likuidimit do te kryhen ne perputhje me dispozitat e ligjit shqiptar.

Neni 19-Ligji i Zbatueshem dhe Juridiksioni

- 19.1 Per çeshtjet e parregulluara ne kete Statut do te zbatohet Ligji nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.
- 19.2 Çdo konflikt, divergjence, mosmarreveshje apo pretendim i çfaredolloji, sidoqe te kete lindur nga apo ne lidhje me kete Statut, do t'i drejtohet dhe zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane

Ky Statut i Shoqerise u hartua ne kater kopje ne gjuhen shqipe, me te njejten vlere.

ORTAKET

ORTAKU I PARE

"GENER 2" Sh.p.k.

Emri: Zj. Artila Ulaj

Pozicioni: Administrator

Artila Ulaj



ORTAKU I DYTE

"ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" Sh.p.k.

Emri: Z. Olset Haxhiu

Pozicioni: Administrator

Olset Haxhiu



ORTAKU I TRETE

"I.D.K - KONSTRUKSION" Sh.p.k.

Emri: Z. Gramos Dalipi

Pozicioni: Administrator

Gramos Dalipi

